REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:113859
Datë: 27.01.2020
Numri i dokumentit: 00786448

P.nr. 1801/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Donikë Dobruna, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.Rr. nga Prishtina, Rruga "...", nr. ...., për shkak të veprës penale Sulm nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 2465/2019 të datës 22.05.2019, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, jashtë seancës me datë 14.01.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr. 2465/2019, e datës 22.05.2019, për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor,

Andaj gjykata komform nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari:

A.Rr., nga i ati Rr. dhe e ëma A., mbiemri i vajzërisë V., i lindur me datë ..... në Prishtinë, jeton në Rrugën "...", nr. ..., ..., i martuar, shofer, ka të kryer shkollën e mesme, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 06.04.2019, rreth orës 7:20 në Prishtinë, saktësisht në Stacionin e Autobusëve te zyra e shefit të ndërrimit i pandehuri për shkak të mosmarrëveshjeve paraprake me të dëmtuarin Sh. D., fillimisht e kishte ofenduar e pastaj me dashje e ka përdorur forcën ndaj tij duke e goditur në duar, në kraharor dhe shpinë,

- **Me këtë ka kryer veprën penale Sulm nga neni 187 paragrafin 1 të KPRK-së.**

2019:113860

Andaj, gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46 dhe 73 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPK-së, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej **300.00 (treqind) €**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës se prerë të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mund ta paguaj deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, duke filluar nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës në këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 paragrafi 3 të KPK-së, i njëjti do te zëvendësohet me dënim me burgim **duke llogaritur çdo 20.00 (njëzet) € me 1 (një) ditë burgim.**

Obligohet: i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia kompensojë shumën prej 30.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

I dëmtuari: Sh. D. nga P., Rruga ".....", p.n., Prishtinë, Kolovica e Re, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr. 2465/2019, të datës 22.05.2019, kundër të akuzuarit A.Rr. me vendbanim në P, Rruga "...", nr. ....., për shkak të veprës penale Sulm nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykatës i është propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj Urdhrin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me besueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 498 të KPPK-së Gjyqtarja e vetme gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si : Kallëzimi penal, procesverbalet, si dhe provat tjera përcjellëse janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj, gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Sulm nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, u mor konform nenit 450 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

2019:113860

Në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha me lart, e në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 1801/2019 të datës 14.01.2020

G j y q t a r j a,

Donikë Dobruna

KËSHILLA JURIDIKE:
Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.

2019:113860